



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE  
KOMISIONI I VOTIMIT

**VENDIM**

**PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESVE**

Në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe nenit 15 të Rregullores nr. 3152/5, datë 11.12.2018, “Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe për procesin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Komisioni i Votimit me përbërje:

**Alma Muça** kryetar;

**Thoma Jano** anëtar;

**Alfred Progonati** anëtar,

pas administroi gjithë dokumentacioni i votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

**VËREN:**

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e një anëtari prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave të vlefshme, renditen në mënyrën si vijon:

**I.** Për anëtar prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

*z. Etien Kapo* **83 vota**

*znj. Ledina Riza* **115 vota**

**II.** Për anëtar prokuror në Këshillin Drejtues të Magjistraturës;

*z. Albert Kuliçi* **100 vota**

*z. Arqilea Koça* **76 vota**

*znj. Elona Alvora* **20 vota**

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, dhe 247, pika 1, shkronja “d” , të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15 të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, komisioni,

### **VENDOSI:**

1. Të shpallë fitues si anëtar prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

**Znj. Ledina RIZA**

2. Të shpallë fitues si anëtar prokuror në Këshillin Drejtues të Magjistraturës;

**Z.Albert KULICI**

3. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 25.10.2022 , ora 13.12

### **Komisioni i Votimit**

**ANËTAR**

**THOMA JANO**

**KRYETAR**

**ALMA MUÇA**

**ANËTAR**

**ALFRED PROGONATI**